

“Ndryshimet demografike globale dhe ndikimi i tyre në gjeopolitikën euro-aziatike” ka qenë tema e leksionit të hapur që prof.dr. Fatos Tarifa ka mbajtur në ambientet e Universitetit të Gjirokastrës.

Prezantimi i prof. Tarifës u përqendrua në rajonin e gjerë të Euroazisë. Ai trajtoi rolin në rënie të Evropës dhe paraqiti tezën e mundësisë së krijimit të një rendi të ri botëror që do të përcaktohet nga e ardhmja e marrëdhënieve mes dy fuqive të mëdha aziatike: Kinës dhe Ruisë.

Ndryshimet demografike dhe gjeo - ekonomia po sjellin ndryshime të thella në rolin dhe ndikimin e fuqive të mëdha në botën e sotme.

Sipas prof. Tarifës rëndësia e fuqisë ushtarake po ia lë vendin fuqisë gjeo-ekonomike.

Prof. Tarifa solli të dhëna të reja, si dhe argumente interesante që vënë në punë intelektin dhe imagjinatën.

Ky takim, që çeli siparin e aktiviteteve të vitit 2022 në UGJ, u zhvillua në formën e një bashkëbisedimi me të pranishmit, pjesë e stafit akademik të universitetit.





